



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____ г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i njohur KSHPK (në tekstin e mëtejshëm) në seancën e 80-të, të mbajtur më 18.01.2023, morri vendimin vijues:

VENDIM

Denoncimi i regjistruar me numër 12-8253/1 datë 22.09.2022, me pretendime të përgjithshme për pengim personal dhe diskriminim, **HIDHET POSHTË.**

KSHPK-ja konstatoi se në pajtim të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, nuk ka elemente për veprim kompetent për rastin në fjalë për shkak se nuk ka pretendime apo indikacione të qarta për veprime të paligjshme apo të palejueshme të personave zyrtarë në ushtrimin e autoritetit publik dhe detyrës zyrtare .

Lënda me numër 12 –8253/1 të datës 22.09.2022 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi i KSHPK-së, në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Më 22 shtator 2022, nga një parashtrues i njohur është dorëzuar denoncim me pretendime të përgjithshme për pengim dhe diskriminim personal dhe është formuar lënda me numër 12-8253/1 i datës 22 shtator 2022.

Në denoncim, parashtruesi pa vënë në dukje veprime konkrete të personave të caktuar në ushtrimin e pushteteve publike dhe detyrave zyrtare, vë në dukje disa ngjarje të palidhura që nuk përmbajnë pretendime për veprime të veçanta korruptive, konkretisht: pengesa në pagesën e pagës dhe përgatitjen e doktoraturës, diskriminimi, mosveprimi ndaj pretendimeve nga auditimi, hakmarrja, veprimi i prokurorisë publike etj.

Pas shqyrtimit të pretendimeve, KSHPK-ja ka konstatuar se pretendimet e denoncuar nuk janë korrupsion sipas përkufizimit të përcaktuar në Ligjin për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit. Duke qenë se denoncimi nuk përmban të dhëna të mjaftueshme për t'i bërë

më konkrete pretendimet e denoncuara, KSHPK-ja vlerësoi se nuk ka elemente për veprim kompetent për rastin në fjalë.

Duke pasur parasysh të theksuarën më sipër, KSHPK vendosi si në dispozitën e këtij vendimi.

Dorëzuar deri:
Parashtruesi i denoncimit

Përgatiti: A.R.M

**KOMISIONI SHTETËRORË
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT
Nënkryetar
Mr. Vlladimir Georgiev**

